

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR
KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Digjitalizimi i informacionit Arkivor dhe Vënia ne dispozicion për akses.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 35721000-4

VLERA E FONDIT LIMIT: 83,333,333 lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar te kembimit te Bankes se Shqipërise kjo vlere konvertohet ne 826,637.56 Euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor FSHZH ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik."

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet e fundit financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jo më pak se dyfishin e vlerës së parashikuar të fondit që prokurohet.

Për operatorët e huaj, në rastet kur në vendin e origjinës nuk lëshohen dokumentet e kërkuara për të vërtetuar bilancet/pasqyrat financiare apo xhiron vjetore, mund të paraqesin një deklaratë për konfirmin e tyre .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, atë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", I ndryshuar, ku bilancet e dy viteve nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shumën e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, OE duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit që prokurohet

a) Në rastin e përvojës së mëparshme nga një ent publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuar nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit që do të thotë që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për shërbime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parashysh objektin, vlerën e kontratës dhe kohezgjatjen.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.a.2 Operatori ekonomik duhet të ketë në të paktën tre vjet përvojë në fushën e teknologjive të informacionit dhe kryesisht në zhvillimin e sistemeve informatike dhe mirëmbajtjen e tyre. Ai duhet të ketë objekt të aktivitetit të tij të regjistruar në QKB, përveç të tjerash dhe zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve informatike. Kjo vërtetohet me paraqitjen e:

- Profili (CV) i Operatorit Ekonomik

Arsyetimi: Referuar Termave të Referencës dhe natyrës së këtij projekti, Operatori Ekonomik duhet që të vërtetojë nëpërmjet objektit të aktivitetit të tij si dhe profilit dhe projekteve që ka zhvilluar që ka një eksperiencë të gjatë në fushën e IT dhe konkretisht në fushën e zhvillimit dhe mirëmbajtje të sistemeve informatike.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë një numër mesatar të punësuarish gjatë tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit jo më pak se 20 (njëzet). Kjo duhet të vërtetohet me paraqitjen e:

- Vërtetim nga Organet Tatimore mbi numrin e punonjësve shoqëruar me listëpagesat sipas formatit që kërkohet nga legjislacionin tatimor.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 9. Formulari I vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit.

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.

Arsyetimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë punonjes të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur duke u bazuar ne shërbimet e kerkuara sipas Termave te references, volumet dhe fazat e projektit, kualifikimi i punonjësve, grafiku i shërbimeve, zerat sipas pershkrimit te produkteve dhe orët e punës, sipas Kodit të Punës etj. Meqenese zhvillimi, permiresimi dhe mirembajtja i nje sistemi per menaxhimin e dokumentave, ku kerkohet nje perpunim te madh te dhenash dhe nje siguri te larte te informacionit si dhe kur kerkohet qe koha e realizimit te kesaj kontrate te jete e shkurter gjykojme se Operatori Ekonomik duhet te kete nje numer jo me te vogel se 20 punonjesish

2.3.4 Operatori ekonomik duhet kete njohuri mbi skanimet, digjitalizimet dhe sistemet e menaxhimit te dokumentave. Kjo duhet te vertetohet me paraqitjen e:

- Kontrate te ngjashme ose me nje dokument tjetër vertetues.

Arsyetimi: Objekti i ketij tenderi eshte ndertimi i nje sistemi per Menaxhimin e dokumentave si dhe skanimet, digjitalizimet.. Ne kushtet kur rendesia e ketij sistemi ne kuader te menaxhimit dhe sigurise se tij eshte shume e rendesishme, si dhe po keshtu afati kohor i realizimit te tij eshte i ngushte, kerkohet qe operatori ekonomik te kete njohuri dhe eksperience te mjaftueshme mbi kete sisteme.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin nga Prodhuesi/distributori i autorizuar, ku operatori ekonomik autorizohet për shitjen e produkteve hardware të përfshira në këtë objekt prokurimi për territorin e Shqipërisë. Në rast të paraqitjes së autorizimit të Distributorit të autorizuar duhet të verifikohet lidhja mes Prodhuesit dhe Distributorit të autorizuar.

Arsyetimi: Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autorizimi i prodhuesit ose distributorit garanton AK mbi aftesine teknike te Operatorit Ekonomik per te furnizuar produktet e kerkuara si dhe per origjinën e blerjes së produkteve objekt prokurimi nëpërmjet kanaleve zyrtare dhe se Operatori Ekonomik është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre produkteve në territorin e Shqipërisë. Ky autorizim garanton gjithashtu AK per cilësinë e produkteve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve më të larta nga prodhues të njohur.

2.3.6 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të vertetoje se ka te punesuar prej 3 (tre) muajsh nga data e zhvillimit të tenderit, te pakten 5 (pese) specialiste IT, te diplomuar ne deget si: Informaticien, Inxhinier Elektronik, Informatike ekonomike e dege te tjera te ngjashme. Nga specialistet e IT, duhet te kete specialiste te cilet ne menyre te kombinuar, te plotesojne kerkesat per certifikime si me poshte:

- a) Të paktën 1 (një) punonjes te certifikuar si Drejtues Projektesh ne fushen e IT dhe me pervoje mbi 10 vjecare ne drejtimin e projekteve ne fushen e IT.

Arsyetimi: Projekti është kompleks dhe kërkon menaxhim të të gjithë komponenteve të tij për realizimin në kohë dhe me cilësi të shërbimeve të kërkuara

b) Të paktën 1 (një) punonjës të licensuar si Projektues dhe Kolaudues i sistemeve komplekse në fushën e komunikimit dhe me përvojë në projekte në fushën e IT.

Arsyetimi: Ky punonjës duhet të jetë mbështetje e Drejtuesit të Projektit, sidomos për eksperiencën në fushën përkatëse

c) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për zhvillimin e aplikacioneve në Web (Web development)

Arsyetimi: Aplikacioni duhet të jetë i bazuar në Web, prandaj kërkohet eksperiencë dhe certifikim në këtë fushë

d) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Datacenter Servers, Networks dhe Storage

Arsyetimi: Për procesin e instalimit, konfigurimit dhe testimit nevojiten njohuritë dhe certifikimet përkatëse

e) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për përdorimin dhe mirëmbajtjen e skanerave.

Arsyetimi: Meqenëse pjesë e shërbimeve të kërkuara janë dhe skanimet e dokumentave, nevojitet njohuri dhe certifikim për pajisjet që do përdoren për këto procese.

f) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar nga prodhuesi për të implementuar dhe instaluar zgjidhjen e ofertuar për infrastrukturën hiperkonvergjente.

Arsyetimi: Duke qenë se pjesë e objektit të prokurimit është Infrastruktura Hiperkonvergjente, kërkohet një specialist i certifikuar për të bërë të mundur instalimin dhe implementimin e zgjidhjes së ofertuar si dhe për të ofruar shërbimin e mirëmbajtjes dhe SLA gjatë kohezgjatjes së kontratës.

g) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivel profesional ose ekuivalent për të implementuar dhe instaluar zgjidhjen e ofertuar për Pajisje për krijimin e kopjes rezervë nga disku në disk.

Arsyetimi: Duke qenë se pjesë e objektit të prokurimit është Pajisje për krijimin e kopjes rezervë nga disku në disk, kërkohet një specialist i certifikuar në nivel profesional ose ekuivalent për të bërë të mundur instalimin dhe implementimin e zgjidhjes së ofertuar si dhe për të ofruar shërbimin e mirëmbajtjes dhe SLA gjatë kohezgjatjes së kontratës.

h) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar nga prodhuesi për të implementuar dhe instaluar zgjidhjen e ofertuar për Software për backup.

Arsyetimi: Duke qenë se pjesë e objektit të prokurimit është Software për backup, kërkohet një specialist i certifikuar për të bërë të mundur instalimin dhe implementimin e zgjidhjes së ofertuar si dhe për të ofruar shërbimin e mirëmbajtjes dhe SLA gjatë kohezgjatjes së kontratës.

i) Të paktën 2 (dy) specialiste të certifikuar në nivel profesional për rrjetat për të implementuar dhe instaluar zgjidhjen e ofertuar për top of the rack switches dhe switch të menaxhueshëm 24 porta.

Arsyetimi: Duke qenë se pjesë e objektit të prokurimit janë edhe top of the rack switches dhe switch të menaxhueshëm 24 porta, të cilat janë pajisje rrjeti, kërkohen 2 (dy) specialiste të certifikuar në nivel

profesional per te bere te mundur instalimin dhe implementimin e zgjidhjes se ofertuar si dhe per te ofruar sherbimin e mirembajtjes dhe SLA gjate kohezgjatjes se kontrates. Niveli profesional garanton AK se punonjesit e Operatorit ekonomik kane ekspertizen dhe kapacitetin profesional per te instaluar dhe implementuar produkte te tilla.

j) Te paktën 1 (nje) specialist te certifikuar ne nivel profesional ose ekuivalent për implementuar dhe instaluar zgjidhjen e ofertuar per Pajisje Sigurie Firewall.

Argumentimi: Duke qene se pjese e objektit te prokurimit eshte edhe Pajisje Sigurie Firewall, kerkohet 1 (nje) specialist te certifikuar ne nivel profesional ose ekuivalent për implementuar dhe instaluar zgjidhjen e ofertuar per Pajisje Sigurie Firewall si dhe per te ofruar sherbimin e mirembajtjes dhe SLA gjate kohezgjatjes se kontrates. Niveli profesional garanton AK se punonjesit e Operatorit ekonomik kane ekspertizen dhe kapacitetin profesional per te instaluar dhe implementuar produkte te tilla.

k) Te paktën 1 (nje) specialist te certifikuar ITIL ose ekuivalent për menaxhimin e shërbimeve IT.

Arsyetimi: Duke qene se projekti eshte i nje rendesie te vecante dhe permban komponente te ndryshem te cilat patjeter kerkojne nje menaxhim profesional per realizimin me sukses te saj, kerkohet 1 (nje) specialist i certifikuar ITIL per menaxhimin e shërbimeve IT si dhe per te ofruar sherbimin e mirembajtjes dhe SLA gjate kohezgjatjes se kontrates.

Për të vërtetuar këtë Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- CV e specialisteve
- Çertifikatat ose licensat e specialisteve e kerkuara me siper.
- Deklarata “Listëpagesat e kontributeve te sigurimeve shoqerore e shendetesore dhe tatimit mbi ardhurave nga punesimi” per periudhen tre mujorit te fundit nga data e zhvillimit të tenderit, te vertetuar nga organet tatimore.

Sqarojmë se: Sa më sipër ne shkronjat nga (a -k) jo të gjithë punonjësit duhen, pasi sipas përcaktimit qe ka kekruar Autoriteti Kontraktor per certifikimin e tyre, nje specialist mund të ketë më shumë se një certifikim. Operatori ekonomik duhet të vertetoje se ka te punesuar prej 3 (tre) muajsh te pakten 5 (pese) specialiste IT

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Ky kriter vërteton eksperiencën në fushën objekt prokurimi me qëllim realizimin e objektit te prokurimit. Përvoja e është element shumë i nevojshëm për autoritetin, për të vërtetuar qendrueshmërinë ekonomike të ofertesit, eksperiencat dhe besueshmërinë në përmbushjen e sukseshme të kontratës. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, vlerësohet në lidhje me personelin tekun te nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Stafi teknik duhet te

angazhohet. Çdo staf teknik do të jete pergjegjes per kryerjen e detyrave te percaktuar per çdo faze te regjistrimit. Për secilin specialist eshte argumentimi si me larte sipas pikave.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 9. Formulari I vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit.

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

"Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur me Çertifikatat:

- a) Çertifikate ISO 9001/2015 te Menaxhimit te Cilësisë ose ekuivalent cila duhet të jete ne te njëjtën fushe me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve qe prokurohen, të vlefshme në periudhën kur zhvillohet tenderi, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Çertifikate ISO 27001 e Sistemit Menaxhial te Sigurise se Informacionit ose certifikate ekuivalente e cila duhet të jete ne te njëjtën fushe me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve qe prokurohen, të vlefshme në periudhën kur zhvillohet tenderi, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Çertifikate ISO/IEC 20000 e Sistemit Menaxhial te Shërbimeve ne fushen e Teknologjise se Informacionit ose certifikate ekuivalente e cila duhet të jete ne te njëjtën fushe me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve qe prokurohen, të vlefshme në periudhën kur zhvillohet tenderi, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Për vet natyrën e veçantë, dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të të sigurisë së informacionit janë standarte që çdo operator e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me cillesi dhe sigurimin e informacionit. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë sigurinë e informacionit ne format copy dhe elektronik ne sistem.. -Përmbushja e standartit ISO 9001 është thelbësore, dhe siguron manaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj çertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka

të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standardeve të cilësisë.

-Përmbushja e standartit ISO 27001 është thelbësor, pasi siguron zbatimin e sigurisë së informacionit të shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka standartet nderkombëtare të duhura për menaxhimin e sigurisë së informacionit gjatë zbatimit të kontratës.

-Nëpërmjet certifikimit ISO/IEC 20000, Operatori Ekonomik duhet të demonstrojë si ofruar shërbimi aftësinë për të planifikuar, implementuar, operuar, monitoruar rishikuar dhe përmirësuar shërbimet e ofruara. Ky lloj certifikimi garanton gjithashtu Autoritetin Kontraktor se shërbimet e ofruara gjatë zbatimit të kontratës janë sipas standardeve ndërkombëtare për menaxhimin e shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit.

(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar shërbimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe nëse është rasti, për llojin e licencës/ certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

Arsyeja pse nuk eshte ndare ne lote: Autoriteti ka vendosur te zhvilloj proceduren pa lote pasi natyra e kontrates nuk eshte e perzier, por vetem Digjitalizimi I informacionit Arkivor te percaktuara ne termat e references, per te cilen ka perzgjedhur per lidhjen e kontrates proceduern e hapur..

III. Kriteret e vlerësimit

Sipas rëndësisë:

- | | |
|--|-----------------|
| 1. Çmimi | pikët 50 |
| 2. Propozimi teknik | pikët 25 |
| 3. Kualifikimet e stafit teknik | pikët 25 |

Pikët maksimale që mund të marrë një Ofertë do të jenë 100.

Kriteri i parë: Çmimi [0-50] pike

Kriteri i cmimit me 50 pikë është i bazuar ne rregullat e prokurimit publik, ku parashikohet minimalisht 50 pike.

Vlerësimi i Propozimeve Ekonomik kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Pe - Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu - Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç - Çmimi Ofertues i Radhës *(duke filluar nga çmimi më i ulët)*

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

Vlerësimi i Propozimeve Teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

Kriteri i dytë: Propozimi teknik

Të gjithë operatorët duhet të përcaktojnë në propozimin teknik, termat/specifikimet minimale të detyrueshme që duhet të plotësojnë sipas dokumentit të tenderit. Oferta do të vlerësohet në bazë të sistemit kalon ose nuk kalon dhe ofertat që arrijnë të kalojnë do të jepen pikë. Pikët do të pasqyrojnë shkallën në të cilën oferta tejkalon specifikimet minimale të detyrueshme.

Vlerësimi i Propozimeve Teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

i. Propozimi teknik	[0-25]
Nënkriteret	
ii/a. Përfaqja teknike dhe propozimi	30%
ii.b Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit	40%
ii.c. Organizimi i Stafit	30%

ii/a. Operatori duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës/specifikimet teknike, përfaqjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme, duke përfutur rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve. Operatori duhet të paraqesë problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përfaqjen teknike që do të adaptojë për zgjidhjen e tyre. Operatori duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adoptojë dhe të paraqesë kompatibilitetin e këtyre metodologjive me përfaqjen e propozuar.

ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit: OE duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përfaqjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret. Një listë e dokumentave përfundimtare përfshirë raportet, vizatimet dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar, duhet përfshirë në këtë kapitull. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e plote të zgjidhjes teknike për të gjitha shërbimet e kërkuara, të shoqëruar me përshkrimin, diagramat, skemat e detajuara dhe produktet e detajuara me modelet perkatëse.

ii/c. Organizimi dhe Stafit: OE duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e operatorit dhe personelin ekonomiko-administrativ.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit sipas nënkritereve të mësipërme

Kriteri i tretë: Kualifikimet e Stafit teknik

ii. Kualifikimet e Stafit teknik [0-25]

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

- | | |
|------------------------------------|------|
| a- Kualifikim i përgjithshëm | 20% |
| b- Eksperienca në fushën përkatëse | 80 % |

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.

- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

Pesha sipas kritereve do të jete si me poshtë:

- Pesha per çmimin më të ulët $Pk1 = (\text{pikët e çmimit} \times 0.5)$
- Pesha për Propozimi teknik $Pk2 = (\text{pikët e stafit} \times 0.25)$
- Pesha për Kualifikimet e Stafit teknik $Pk3 = (\text{pikët e metodologjise} \times 0.25)$

Formula me të cilën llogariten pikët e ofertuesve, në çdo rast duhet të jetë:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Ku:

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar

Pikët për secilin kriter llogariten sipas formulës:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

Pmaxk1 Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

Termat e references jane hartuar sipas standardeve dhe ne perputhje me perckatimet ligjore ne fuqi dhe jane pjese e pandare e DST